Aneks 1: Tipologjia e shkollave të përfshira në Lotin 1

Në lotin 1 është parashikuar ndërtimi i 5 (pesë) shkollave, përkatësisht 2 (dy) shkolla të reja në Njësinë Administrative nr. 9 dhe 3 (tre) në Njësinë Administrative nr. 11. Më konkretisht, në Njësinë Administrative nr. 9 është parashikuar të ndërtohet një shkollë e ciklit arsimor bazë të tipit 1 dhe një shkollë e ciklit arsinor të mesëm të lartë, pra e tipit 4.
Ndërsa në Njësinë Administrative nr. 11 janë parashikuar të ndërtohen dy shkolla të ciklit arsimor bazë të tipit 2 dhe një shkollë e tipit 4. Në tabelën si më poshtë mund të shihen më në detaj dallimet mes tipeve të shkollave sipas vendndodhjes, ciklit arsimor, numrit të klasave, numrit të nxënësve për klasë etj.

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Numri i klasave	Nxënës për klasë	Numri i nxënësve total	m^2 për nxënës	Sipërfaqe totale
Tipi 1	**Urban**	**Arsimi bazë**	**20**	**30**	**600**	**8.23**	**4938**
Tipi 2	**Urban**	**Arsimi bazë**	**30**	**30**	**900**	**7.32**	**6588**
Tipi 3	**Rural**	**Arsimi bazë**	**20**	**24**	**480**	**8.42**	**4041.6**
Tipi 4	**Urban**	**I mesëm i lartë**	**21**	**30**	**630**	**6.35**	**4000.5**

Zgjidhja e tipologjisë arkitektonike të shkollave:
- Planvendosja e objektit në terren
- Marrëdhënia me kontekstin urban dhe hapësirën publike
- Marrëdhënia mes hapësirave të jashtme e të brendshme

Zgjidhja e organizimit të funksioneve të parashikuara
- Zgjidhja e ofruar për organizimin funksional
- Zgjidhja planimetrike dhe drita natyrale
- Skema e qarkullimit për personat me aftësi të kufizuar
- Integrimi i kopshtit me shkollën 9-vjeçare

Aneksi 2: Zona e koncesionit

Vendndodhja e shkollave të përfshira në Lotin 1:
Zona e Koncesionit përbëhet nga sheshet/trojet sipas certifikatave të pronësisë, kartelave dhe hartave treguese që përshkruhen si më poshtë:



Sipërfaqet totale që do zihen në mënyrë të përhershme nga sheshet e shkollave të përfshira në Lotin 1

Sheshi 9/1
Ortofoto e sheshit

VENDODHJA: Shesh i propozuar nr.9/1 ndodhet pranë lagjes "Don Bosko". Eshtë një zonë në zhvillim ku vërehen tipologji banimi shumë katëshe dhe banesa të ulëta një familjare informale.
TË DHENA TEKNIKE: Sheshi 9/1:Sipërfaqe – 12989 m^2
GJENDJA AKTUALE E SHESHIT:

- Eshtë një zonë e qetë relativisht.
- Aksesi në shesh është i lehtë. Problematike mund të jetë infrastruktura rrugore. Paraqet shumë aspekte pozitive, pasi ndodhet në një zonë me intensitet të lartë banimi.
- Në këtë zonë nuk ka shkolla të mësme.
- Sheshi përfshin në territorin e tij një objekt të vjetër magazinimi, por shihet interesant për shkak të shtrirjes dhe sipërfaqes të madhe.

Foto të sheshit 9/1

SHESHI 11/1
Ortofoto e sheshit

VENDNDODHJA: Sheshi i propozuar nr. 11/1 ndodhet brenda kompleksit universitar të Univeritetit Bujqësor të Tiranës. Ky shesh kufizohet nga rruga "Taulantët" dhe bulevardi "Blu".

TË DHËNA TEKNIKE: Sheshi 11/1: Sipërfaqe -8,967 m^2
GJENDJA AKTUALE E SHESHIT:
-Është një zonë e paprekur me gjelbërim të ulët.
- Sheshi ka pjerrësi të konsiderueshme.
- Problematike është infrastruktura rrugore
-Aksesi në shesh është i vështirë

Foto të sheshit 11/1

SHESHI 11/2

Ortofoto e sheshit

VENDNDODHJA: Sheshi i propozuar nr. 11/2 ndodhet pranë rrethrrotullimit të Doganës. Aksesohet nga rruga "Vangjel Noti".

TË DHËNA TEKNIKE: Sheshi 11/2: sip 14102 m^2

GJENDJA AKTUALE E SHESHIT:

- Ndodhet pranë qendrës së banuar të zonës
- Akses i lehtë

Foto të sheshit 11/2

Sheshi 9/1 Harta treguese e pronave



Sheshi 11/1

Harta treguese e pronave



Sheshi 11/2

Harta treguese e pronave



Aneksi nr. 3 Kalendari i pagesave

Tabela e llogaritjes se pagesave vjetore ndaj Koncesionarit:

A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N
Nr rendor	Viti	Kosto Direkte e Investimit ne Fillim të Periudhës (pa TVSH) (C3=F2)	Marzhi i fitimit	Shlyerja vjetore për Koston Direkte të Investimit (C2/B8)	Marzhi i fitimit mbi koston Direkte të investimit (C*D)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (E+F)	kosto vjetore mirembajtjeje Pa TVSH	Marzhi i fitimit mbi Mirembajtjen (D*H)	pagesa vjetore për koston direkte të investimit Pa TVSH (I+H)	Total Marzhi i Fitimit	Tarifa Vjetore Pa TVSH	TVSH	Tarifa Vjetore Me TVSH
1	0	1,600,861,766.83											
2	1	1,600,861,766.83	6.28%	228,694,538.12	100,534,118.96	329,228,657.08	48,537,258.00	3,048,139.80	51,585,397.80	103,582,258.76	**380,814,054.88**	**76,162,810.98**	**456,976,865.85**
3	2	1,372,167,228.71	6.28%	228,694,538.12	86,172,101.96	314,866,640.08	48,537,258.00	3,048,139.80	51,585,397.80	89,220,241.77	**366,452,037.88**	**73,290,407.58**	**439,742,445.46**
4	3	1,143,472,690.59	6.28%	228,694,538.12	71,810,084.97	300,504,623.09	48,537,258.00	3,048,139.80	51,585,397.80	74,858,224.77	**352,090,020.89**	**70,418,004.18**	**422,508,025.07**
5	4	914,778,152.47	6.28%	228,694,538.12	57,448,067.98	286,142,606.09	48,537,258.00	3,048,139.80	51,585,397.80	60,496,207.78	**337,728,003.90**	**67,545,600.78**	**405,273,604.68**
6	5	686,083,614.36	6.28%	228,694,538.12	43,086,050.98	271,780,589.10	48,537,258.00	3,048,139.80	51,585,397.80	46,134,190.78	**323,365,986.90**	**64,673,197.38**	**388,039,184.28**
7	6	457,389,076.24	6.28%	228,694,538.12	28,724,033.99	257,418,572.11	48,537,258.00	3,048,139.80	51,585,397.80	31,772,173.79	**309,003,969.91**	**61,800,793.98**	**370,804,763.89**
8	7	228,694,538.12	6.28%	228,694,538.12	14,362,016.99	243,056,555.11	48,537,258.00	3,048,139.80	51,585,397.80	17,410,156.80	**294,641,952.91**	**58,928,390.58**	**353,570,343.50**
								21,336,978.62	**361,097,784.62**	**423,473,454.44**	**2,364,096,027.27**	**472,819,205.45**	**2,836,915,232.73**

ɔageses
60 diteve nga "Data Efektive"
ı "Data Efektive"
ı pagesa paraardhese per Koston Direkte te Investimit
ı pagesa paraardhese per Mirembajtjen
ı pagesa paraardhese per Koston Direkte te Investimit
ı pagesa paraardhese per Mirembajtjen
ı pagesa paraardhese per Koston Direkte te Investimit
ı pagesa paraardhese per Mirembajtjen
ı pagesa paraardhese per Koston Direkte te Investimit
ı pagesa paraardhese per Mirembajtjen
ı pagesa paraardhese per Koston Direkte te Investimit
ı pagesa paraardhese per Mirembajtjen
ı pagesa paraardhese per Koston Direkte te Investimit
ı pagesa paraardhese per Mirembajtjen

Aneksi 4

Manuali i Mirëmbajtjes

PËRMBAJTJE

1 HYRJE 7

1.1. Rëndësia e mirëmbajtjes së shkollave 8
1.2. Përse nevojitet Udhëzimi me Doracakun
për mirëmbajtjen e shkollave? 9
1.3. Cilat janë qëllimet e Udhëzimit me Doracakun? 10
1.4. Kush e përpunoi Udhëzimin me Doracakun?..... 10
1.5. Kujt i dedikohet ky Udhëzim me Doracak?..... 11
1.6. Çfarë përmban Udhëzimi me Doracakun ?..... 11

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

HYRJE

Problemi i mirëmbajtjes së ndërtesave fizike është universal dhe marrja parasysh e këtij problemi në fazën e projektimit është me rëndësi jetike: në fazat e hershme të projektimit të cilësdo ndërtesë, duhet të vendoset, përveç sasisë së hapësirës së nevojshme, kohëzgjatja e dëshiruar e ndërtesës dhe shuma e parave që duhet të shpenzohet si për shpenzimin e gjithëmbarshëm dhe në mirëmbajtje. Gjatë përgatitjes projektimit, duhet të merren vendime sa i përket shpenzimeve kapitale sa i përket riparimit vjetor dhe kostos së zëvendësimit, si dhe kohëzgjatjes përfundimtare që pritet të ketë një ndërtesë. Këto vendime do të kenë efekte jetike në masën e mirëmbajtjes që do të kërkojnë ndërtesat e reja gjatë kohëzgjatjes së tërësishme të shfrytëzimit të tyre. Duhet të kuptohet qartë se kostoja më e ulët fillestare nuk është më ekonomikja në afatgjatë, pasi që shumë materiale të lira do të kërkojnë shumë më shumë mirëmbajtje dhe mund të kenë afat më të shkurtër funksionimi sesa disa të tjera që janë më adekuate, por që janë alternativa më të shtrenjta. Për shembull, kjo është posaçërisht e vërtetë për mbarimet e mureve dhe të kateve të cilat i nënshtrohen harxhimit dhe brejtjes së vazhdueshme. Vendi i parë për t'i parandaluar defektet dhe zvogëluar nevojat për mirëmbajtje është në përgatitjen e një projektimi fillestar të përshtatshëm, dhe për ta arritur këtë, sistemit të mirëmbajtjes duhet t'i kushtohet më shumë rëndësi në projektimin e të gjitha shkollave të reja. Inxhinierët dhe teknikët e mirëmbajtjes duhet të konsultohen në secilën fazë të ngritjes së konstruksioneve të reja.

Ata duhet t'i kontrollojnë këto pika:

(i) Në fazën e planifikimit: madhësitë, sasitë dhe performancat e hapësirave duhet të përkojnë me detyrat dhe përdorimin e tyre real. Kjo duhet të pasqyrohet në përmbledhjet e projektit dhe të kontrollohet para nisjes së fazës së projektimit. Për shembull, numri i kabinave të tualetit që duhet të përkojë me numrin real të nxënësve (rreth 30 nxënës për një dhomëz tualeti).

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

Në të kundërtën, përdorimi tejmase i kabinave të tualetit do të nxisë përkeqësim të shpejtuar të të gjitha elementeve (të sistemit gypave të kanalizimit, lëshuesve të ujit, dyerve, rezervuarëve septikë dhe gropëzat e WC-ve) me, mes tjerash, bllokimin e shpeshtë të kanalizimit;

(ii) Analiza e kostos-përfitimit duhet të përgatitet, duke marrë parasysh koston e vlerësuar të mirëmbajtjes parandaluese dhe korrigjuese gjatë ciklit jetësor të një ndërtese. Specialistët e mirëmbajtjes duhet të jenë të aftë të rekomandojnë modifikime nëse kostoja e mirëmbajtjes është tepër e lartë, krahasuar me koston e investimit.

(iii) Në fazën e projektimit të projektit, zgjedhja e materialeve, teknikat e montimit dhe të konstruktimit duhet të kontrollohen përmes përdorimit të kriterit të balancimit të kostos, komoditetit, qëndrueshmërisë strukturale, etj.. Për shembull, shfrytëzimi i kapakëve për pesha të rënda, lëshuesve të ujit dhe gropëzave është domosdoshmëri nëpër shkolla kur të gjitha këto elemente shpesh anashkalohen;

(iv) Gjatë fazës së projektimit, specifikacionet për të gjitha elementet e ndërtesës duhet të kontrollohen, duke patur parasysh, sasinë e punëve të mirëmbajtjes që duhet të sigurohen gjatë ciklit jetësor të secilit element;

(v) Gjatë zbatimit, duhet të sigurohet mbikëqyrje efektive gjatë gjithë fazës së konstruksionit. Mbikëqyrësve duhet t'u jepet fleksibilitet i mjaftueshëm për të qenë në gjendje t'i korrigjojnë të gjitha defektet para certifikimit përfundimtar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIATI

1. HYRJE. TE PERGJITHSHME

Mobiljet, Pajisjet dhe Mjetet Shkollore të jenë në gjëndje funksionale por Koncesionari nuk ka detyrim për të ri-investuar dhe dorëzuar në gjëndje funksionale Mobiljet, Pajisjet dhe Mjetet Shkollore të cilat (x) jane te konsumueshme dhe konsumohen (si psh. reagente) ose/dhe (y) Mobiljet, Pajisjet dhe Mjetet Shkollore të cilat janë konsumuar në masë të tillë që nuk janë më funksionale, sipas amortizimit normal sipas legjislacionit tatimor në fuqi në Republikën e Shqiperisë.

Për Mobiljet, Pajisjet dhe Mjetet Shkollore për të cilat Koncesionari gjykon që nuk janë më të përdorshme dhe të cilat janë amortizuar në masën sa nuk janë më të përdorshme edhe sipas legjislacionit tatimor në fuqi në Republikën e Shqiperisë, Koncesionari do dërgoje një kërkesë tek AK për inspektimin e tyre sa më shpejt. AK duhet të zhvillojë inspektimin me praninë e Koncesionarit brenda1 muaji nga data e këtij njoftimi, në të kundërt Koncesionari ka të drejtë të veprojë sipas gjykimit të tij në lidhje me Mobiljet, Pajisjet dhe Mjetet Shkollore të amortizuara.

Për mobiljet të cilat janë pjesë e njoftimit të Koncesionarit të cilat sic konstatohet nga inspektimi fizik kanë dalë jashtë funksionit si dhe janë amortizuar duke mos qënë më të përdorshme në përputhje me normën e amortizimit të përcaktuar në legjislacionin tatimor, pavarësisht përpjekjeve më të mira të Koncesionarit për t'i mbajtur ato në gjëndje funksionale edhe pas përfundimit të ciklit të amortizimit, AK ka detyrimin t'i zëvendësojë ato me kostot e tij dhe Koncesionari në rast zëvendësimi ka detyrimin të kryejë mirëmbajtjen e tyre sipas kësaj Kontrate.



ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

1.1. RËNDËSIA E MIRËMBAJTJES SË SHKOLLAVE

Fëmijët kanë pozitë qendrore në bashkësi. Pas shtëpisë dhe familjes, shkolla është vendi më i rëndësishëm në të cilin qëndrojnë dhe mësojnë fëmijët. Objekti shkollor, klasat dhe hapësirat e tjera në shkolla duhet të kenë qasje dhe të jenë të këndshme për qëndrimin e nxënësve për zhvillimin e mësimit. Shkollat duhet të jenë model për nxënësit për atë se si duhet të duket një shkollë dhe çfarë kushtesh duhet të mundësojë për zhvillimin cilësor të mësimit.

Shkollat e reja, të renovuara dhe të mirëmbajtura për ta ruajtur dukjen dhe për të qenë funksionale për një periudhë më të gjatë, duhet të menaxhohen në mënyrë përkatëse si dhe të mirëmbahen në kohë dhe në mënyrë profesionale.

Mirëmbajtja e shkollave është e rëndësishme edhe nga aspekti ekonomik. Me mirëmbajtjen e duhur të objektit shkollor, me shfrytëzimin racional të burimeve energjetike dhe me instalimin e materialeve me efikasitet energjetik, shkolla do të kursejë energji, që do të thotë se do të harxhojë më pak mjete financiare gjatë punës. Me mjetet e kursyera për mirëmbajtje, shkolla do të mund të investojë në përmirësimin e kushteve për të qëndruar në shkollë, si dhe në modernizimin dhe zhvillimin e procesit arsimor.



FOTOGRAFIA 1: Aspekti ekonomik i mirëmbajtjes së objekteve shkollore

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

Udhëzimi përqendrohet në:

- Problemet e zakonshme me të cilat zakonisht ballafaqohen shkollat dhe personeli teknik gjatë mirëmbajtjes;
- Mënyrat praktike për zgjidhjen e tyre;
- Rekomandimet për mirëmbajtjen parandaluese, masat për mbrojtje gjatë punës;
- Veglat e nevojshme për mirëmbajtjen e shkollave.

Në shtojcë të Udhëzimit janë dhënë materiale – tabela të cilat mund të përdoren gjatë mirëmbajtjes ditore, mujore dhe vjetore të shkollave, në të cilat theksohet personi përgjegjës për mirëmbajtje nëpër pozita dhe procedura të cilat zbatohen për zhvillimin cilësor të procesit të mirëmbajtjes.

Rezultatet/efektet nga zbatimi i këtyre planeve, standardeve dhe rekomandimeve gjatë mirëmbajtjes së objekteve shkollore kanë të bëjnë me:

- Rritjen e nivelit të higjienës në shkollë;
- Përmirësimin e kushteve për qëndrimin e nxënësve në objekt;
- Rritjen e afatit të eksploatimit të sistemeve dhe materialeve (dyer, dritare, dysheme etj.) të vendosura në objekt;
- Zvogëlimin e shpenzimeve për ngrohje;
- Rritjen e efikasitetit energjetik në objekt.

2. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE



ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

Mirëmbajtja e objekteve shkollore paraqet një përmbledhje aktivitetesh, periudhash kohore dhe personash të obliguar të cilët duhet të organizohen dhe të veprojnë në mënyrë të organizuar dhe të dobishme. Për të qenë mirëmba- jtja e suksesshme, duhet të bëhet një plan për mirëmbajtje, i cili do t'u përgjigjet katër pyetjeve – ÇFARË? KUR? KUSH? SI?

Nëse përgjigjet e këtyre katër pyetjeve definohen në mënyrë precize, evidentohen qartë dhe zbatohen në mënyrë praktike, atëherë mirëmbajtja e objektit shkollor do të jetë shumë më e suksesshme, më efikase dhe më efektive.

> Mirëmbajtja është aktivitet i vazhdueshëm dhe i përditshëm i shkollës, i cili duhet të organizohet në mënyrë sistematike dhe proaktive.

Mirëmbajtja efektive e objekteve shkollore i mbron investimet kapitale, kujdeset për shëndetin dhe për sigurinë e fëmijëve dhe të punësuarve dhe siguron kushte për zhvillimin e procesit arsimor.

Faktorë të ndryshëm në procesin arsimor kanë role, obligime dhe përgjegjësi të ndryshme në mirëmbajtjen e objekteve shkollore.

Personat qe do te bejne mirembajtjen duhet te dine qe:

- Mirëmbajtja e objekteve shkollore kontribuon për mirëqenien fizike dhe financiare të shkollës;
- Mirëmbajtja e objekteve shkollore ndikon mbi dukjen e objektit, funksionimin e pajisjeve, shëndetin e nxënësve dhe personelit dhe zhvillimin e procesit mësimor;
- Për mirëmbajtjen e objekteve shkollore nevojiten mjete financiare;

- Planifikimi strategjik për mirëmbajtjen e objekteve shkollore është punë ekipore, me ç'rast nevojitet kontribut dhe ekspertizë e faktorëve të ndryshëm;
- Mirëmbajtjen duhet ta koordinojnë në kuadër të shkollës;

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

2.1. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: PJESA NDERTIMORE

Mirëmbajtja e objektit është aktivitet i vazhdueshëm dhe i përditshëm i shkollës, i cili duhet të organizohet në mënyrë sistematike dhe proaktive për t'u parandaluar nevoja e riparimeve më të mëdha. Në përgjithësi, mirëmbajtja mund të ndahet në mirëmbajtje të paplanifikuar dhe të planifikuar.

MIRËMBAJTJA E PAPLANIFIKUAR

Mirëmbajtje intervente (reaktive – korrigjuese)

- ndërmerren masa pasi të ndodh një defekt apo do të vërehet dëmtim më i madh. Kjo është mënyra më e zakonshme e mirëmbajtjes, gjerësisht rreth 50% e programeve për mirëmbajtjen e shkollave fokusohen në këtë lloj të mirëmbajtjes. Mirëmbajtja e paplanifikuar në bazë të mirëmbajtjes korrigjuese, si reagim ndaj gjatë dëmtimeve të papritura, rastësore apo të qëllimshme (vandalizëm).

MIRËMBAJTJA E PLANIFIKUAR

Mirëmbajtja parandaluese (proaktive) – mirëmbajtje me qëllim që të parandalohet dëmtimi i objektit apo ndonjë defekt i pajisjeve. Bëhet në intervale kohore të rregullta gjatë vitit shkollor dhe jo si reagim i dëmit të krijuar. Siç tregon edhe emri, mirëmbajtje e planifikuar do të thotë se për mirëmbajtjen e shkollës përgatitet plan i aktiviteteve që në mënyrë të organizuar, koordinuar dhe kontrolluar duhet të zbatohen.



FOTOGRAFIA 2: Pjesë përbërëse të mirëmbajtjes së pozitave ndërtimore

Nga shkollat pritet të miratojnë plan të përcaktuar paraprakisht per mospengimin e procesit mesimor.

Mirëmbajtja e gjendjes ndertimore paraqet kontroll të planifikuar dhe të rregullt të të gjitha pozitave ndërtimore të objektit në të cilat bëjnë pjesë: dyert, dritaret, çatia, muret, fasadat, dyshemetë, tavani si dhe oborret, shtigjet dhe platformat për personat me aftesi ndryshe.

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

2.1. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: PJESA NDERTIMORE

2.1.1. DRITARET

2.1.1.1. EKSPANSIONI TERMIK (DILATACIONI) TE DYERT DHE DRITARET

Dilatacioni paraqet zgjerimin apo shtrirjen e profileve prej të cilave janë përpunuar dyert dhe dritaret për shkak të ndryshimit të temperaturës.

Dyert dhe dritaret nën ndikimin e temperaturave të larta varësisht materialit nga i cili janë përpunuar, në periudhën e verës përhapen edhe atë:

Alumini	➡	**1,2 mm**
PVC	➡	**3–4 mm**
Të drurit	➡	**varësisht nga cilësia e drurit**

Gjate mirembajtjes duhet patur kujdes ky efekt gjate zevendesimit te pjeseve te dritareve apo e gjithe dritarja.

2.1.1.2. SHKËPUTJA E FLETËS MBROJTËSE NË KOHË

Pas përfundimit të montazhit të dyerve dhe dritareve duhet të hiqet fleta mbrojtëse në periudhë prej një muaji. Nëse fleta qëndron për një periudhë më të gjatë (varësisht prej rekomandimeve të prodhuesit, mesatarisht duhet të hiqet më së voni 3 muaj nga vendosja) paraqiten vështirësi gjatë shkëputjes, ndërsa mund të ndodhin edhe dëmtime.

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

2.1. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: PJESA NDERTIMORE

2.1.1. DRITARET

TABELA 1: Zgjidhja e problemeve gjatë përdorimit të dritareve dhe dyerve të aluminit

ZGJIDHJA E PROBLEMEVE GJATË PËRDORIMIT TË DRITAREVE DHE DYERVE TË ALUMINIT		
PROBLEME	MASA	**VEGLA TË NEVOJSHME**
Funksionim i vështirësuar i mekanizmave.	X Shtrëngimi.	**X Çelës - inbus.**
Lagështia e xhamit.	X Silikonizimi.	**X Kaçavidhë;** **X Çelës - inbus;** **X Çekan prej druri.**
Doreza të dëmtuara.	X Ndërrimi.	**X Kaçavidhë;** **X Çelës - inbus;** **X Trapan.**
Goma të dëmtuara.	**X Ndërrimi.**	

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

2.1. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: PJESA NDERTIMORE

2.1.2. ÇATIA

Çatia është pjesë e objektit shkollor e cila e mbron objektin nga:

- Rrezatimi ultraviolet;
- Bora, shiu, ngrirja, vesa, vetëtima etj.

Në objektet shkollore karakteristike janë dy tipe të çative:

- Çati e sheshtë;
- Çati e pjerrët.

2.1.2.1. KONTROLLI I GJENDJES NË SIPËRFAQEN E ÇATISË

Tre lloje të mbulesave të çative janë të përfaqësuara te objektet shkollore:

- Mbulesë me tjegulla qeramike;
- Mbulesë me perberje sandwich;
- Tarraca

Sipërfaqja e çatisë duhet të kontrollohet në çdo 3 deri në 6 muaj.

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

2.1. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: PJESA NDERTIMORE

2.1.2. ÇATIA

Në objektet shkollore karakteristike janë dy tipe të çative:

- Çati e sheshtë;
- Çati e pjerrët.

2.1.2.1. KONTROLLI I GJENDJES NË SIPËRFAQEN E ÇATISË

Tre lloje të mbulesave të çative janë të përfaqësuara te objektet shkollore:

- Mbulesë me tjegulla qeramike;
- Mbulesë me perberje sandwich;
- Tarraca

Sipërfaqja e çatisë duhet të kontrollohet në çdo 3 deri në 6 muaj.

2.1.2.3. INSTALIMI I RRUFEPRITËSIT

Një pjesë e instalimit elektrik të objektit ka për qëllim që mundësinë e goditjes së objektit nga rrufeja ta reduktojë në minimum.

Ai përbëhet nga pritësi i rrufesë, i cili e tejkalon objektin e mbrojtur, tokëzuezin dhe dërgimin e rrymimit të rrufesë, i cili e lidh pritësin me tokëzuesin. Këto tri pjesë të instalimit të jashtëm të rrufepritësit në literaturë mund të gjenden edhe nën termat:

1) Sistem pritës;
2) Tokëzues dhe
3) Sistemi për tokëzim.

Kontrolli i instalimit të rrufepritësit të bëhet çdo dy vjet, ndërsa kontrollin e bën një kompani e licencuar e autorizuar për testimin e instalimeve të rrufepritësit;

Kontrolli i instalimit të rrufepritësit duhet të bëhet kur:

- **Bëhen riparime të caktuara të çatisë apo tarraces;**
- **Pas goditjes së rrufesë në instalime apo në objekt.**

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

2.1. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: PJESA NDERTIMORE

2.1.3. MURET

2.1.3.1. MURET E JASHTËM DHE FASADA

Muret e jashtëm dhe fasada e mbrojnë objektin nga shiu, bora, era, pluhuri dhe ajri i ndotur. Mënyra dhe materialet prej të cilave janë mbrojtur muret dhe fasada ndikojnë në mbrojtjen nga i nxehti dhe i ftohti, mbrojtjen kundër zjarrit, lëshimin e avullit pa paraqitjen e kondensimit në sipërfaqet e tyre dhe brenda, kursimin e energjisë dhe mbrojtje nga zhurma e jashtme.

Probleme më të zakonshme të cilat paraqiten te muret e jashtëm janë çarjet e mureve dhe heqja e grafiteve nga fasada.

2.1.3.3. MURET E BRENDSHME DHE TAVANET

Lyerja paraqet mirëmbajtje të rregullt të mureve të brendshme. Lyerja e mureve përbëhet nga:

- Një shtresë e bojës bazë (lyerja bazë e të gjitha llojeve të substrateve para lyerjes së fasadave dhe bojërat e brendshme);
- Bojëra uji, dy shtresa (për përdorim të brendshëm).

Problemet të cilat paraqiten te muret e brendshme janë çarja e mureve dhe paraqitja e lagështisë së mureve dhe tavanëve.

Njollat e lagështa në tavan zakonisht paraqiten gjatë rrjedhjes nga konstruksioni i çatisë, paraqitja e lagështisë dhe kondensimi. Para se të bëhet sanimi i këtyre njollave, fillimisht nevojitet të zbulohet shkaktari i lagështisë, të ndërmerren masa për sanimin e rrjedhjes, ndërsa më pas të lihen njollat e lagështa që të thahen. Pasi të thahet pjesa ku kanë qenë njollat e lagështa, nevojitet lyerje me shtresë të re të bojës.

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

2.1. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: PJESA NDERTIMORE

ZGJIDHJA E PROBLEMEVE GJATË ÇARJES SË MUREVE DHE MËNJANIMI I GRAFITEVE NGA FASADA		
PROBLEME	MASA	VEGLA TË NEVOJSHME
Çarja e mureve.	• Pastrimi i bazës; • Vlerësimi i thellësisë së çarjes; • Mbushja e pjesës së çarë me rrëshirë epokside apo llaç; • Nivelim me shpatull për të mos pasur gunga; • Lyerje.	X Pastruese për mur (gërryese); X Furçë; X Rulë sfungjeri.
Grafite në fasada.	• Pastrimi i sipërfaqes; • Vendosja e prajmerit si bazë. Prajmeri paraqet lyerjen bazë, gjegjësisht shtresën lidhëse të substratit. Ai i ndërthur pjesët e pluhurit të cilat nuk mund të mënjanohen me pastrim, mundëson ngjitjen më të mirë të lyerjes dhe e përforcon bazën. Aplikohet një shtresë me furçë; • Pas aplikimit të lyerjes bazë është e nevojshme të bëhet aplikimi final me bojë. Boja duhet të aplikohet mirë dhe të cilësohet me rezistencë të lartë të ujit dhe qëndrueshmëri gjatë kushteve të ndryshme kilmaterike.	X Furçë; X Rulë sfungjeri.

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

2.1. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: PJESA NDERTIMORE

ZGJIDHJA E PROBLEMEVE GJATË PARAQITJES SË LAGËSHTISË DHE LYERJA E MUREVE DHE TAVANËVE TË CILAT KANË NJOLLA LAGËSHTIE		
PROBLEME	MASA	VEGLA TË NEVOJSHME
Paraqitja e lagështisë në tavane dhe në muret e brendshme; Paraqitja e lagështisë në dysheme.	X Zbulimi i shkaktarit të lagështisë; X Sanimi i shkakut: riparimi i çatisë, ulluqeve, hidroizolimi, mënjanimi i lagështisë kapilare.	X Shkallë; X Trapanë; X Silikon; X Gozhda; X Doreza.
Lyerja e mureve të brendshme të cilat kanë njolla të lagështisë.	X Sipërfaqet pastrohen që të mënjanohet pluhur nga muret; X Aplikimi i lyerjes përkatëse bazë; X Lyerja e murit me aplikim të barabartë të bojës. Gjatë lyerjes finale të sipërfaqeve rula duhet lëvizur prej lartë-poshtë dhe anasjelltas, me ç'rast sipërfaqja e murit merr pamjetë balancuar; X Intervali kohor prej aplikimit të parë derinë aplikimin e shtresës së dytë duhet të jetë 4–6 orë.	X Leckë gjysmë e lagur; X Pastrues për mur; X Furçë; X Rulë sfungjeri.

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

2.1. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: PJESA NDERTIMORE

Lyerja e mureve të brendshme bëhet në interval kohor prej tre deri në pesë vjet. Muret duhet lyer me bojëra të ndritshme ndërsa tavanet me bojë të bardhë.

Boja mbrojtëse e mureve aplikohet në lartësi prej 1,2 metrash.

Ato duhet të jenë:

- Me bazë uji;
- Të mos përmbajnë aceton, amoniak apo formaldehidit;
- Të mos përmbajnë metale të rënda dhe kompozime organike të paqëndrueshme.

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

2.1. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: PJESA NDERTIMORE

2.1.4. DYSHEMETË

Dyshemetë në shkolla mbulohen me një shtresë dyshemeje varësisht nga lloji dhe madhësia e hapësirës. Në klasa, kabinete, zyra dhe hapësira të tjera në të cilat qëndrojnë nxënësit dhe punonjësit, vendosen dysheme të ngrohta, ndërsa në korridore, tualete dhe hapësirat ndihmëse vendosen dysheme të ftohta.

Ekzistojnë më shumë lloje të dyshemeve të cilat përdoren në shkolla dhe ato janë të përpunuara nga:

- Shtresa PVC për dysheme, heterogjene, në formë rrotulle me trashësi prej 2 mm dhe shtresa finale me mbrojtje ekstreme;
- Materiale në bazë të drurit (parket, laminat, dysheme druri);
- Pllaka vinase;
- Rrëshirë epokside

Dyshemetë mirëmbahen sipas rekomandimeve të prodhuesit.

Gjatë mirëmbajtjes nevojitet fshirja dhe pastrimi i përditshëm me leckë të lagësht dhe heqja e çamçakëzëve; kontroll mujor; pastrim vjetor me makinë.

2.1.4.1. NDËRRIMI I NËNSHTRESAVE TË MOBILIEVE PREJ GOME ME PLASTIKE

Nënshtresat paraqesin mbrojtje të teheve të mobilieve që të mos vijë deri te dëmtimi i dyshemesë prej PVC-je. Nevojitet ndërrimi i teheve prej gome me plastike, pasi që prej gome lënë gjurmë në dyshemenë PVC. Nevojitet kontroll i rregullt i mobilieve (b dhe karrigeve) dhe ndërrimi i teheve të dëmtuara.

2.1.4.2. NDËRRIMI I LISTELAVE TË DËMTUAR

Duhet bërë kontrolli i vazhdueshëm i listelave. Aty ku ka dëmtime, nevojitet ndërrime i listelave të vjetra me të reja.

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

2.1. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: PJESA NDERTIMORE

ZGJIDHJA E PROBLEMEVE GJATË MIRËMBAJTJES SË DYSHEMEVE TË PVC-SË		
PROBLEME	MASA	VEGLA TË NEVOJSHME
Pastrimi i njollave nga lapsat me ngjyrë, salca e domateve, senfi, yndyrërat etj.	X Njollat pastrohen me ujë të nxehtë në të cilin ka ilaç për pastrim; X Sipërfaqja e dyshemesë pastrohet me leckë dhe lustrohet në pajtim me udhëzuesin e prodhuesit për dysheme.	X Leckë; X Ilaçe për pastrim; X Xhoger (leckë pastrimi); X Leckë dhe ilaçe për pastrim.
Pastrimi i njollave nga ndryshku.	X Njollat nga ndryshku pastrohen me ujë në të cilin ka ilaç për pastrim; X Sipërfaqja e dyshemesë pastrohet me leckë dhe lustrohet në pajtim me udhëzuesin e prodhuesit për dysheme.	X Ilaç për pastrimin e ndryshkut; X Leckë;
Pjesë të shkëputura të dyshemesë prej PVC-së.	Nevojitet të bëhet kontrolli i dyshemesë së vendosur prej PVC-së; Nëse ekzistojnë pjesë të shkëputura nevojitet të bëhet vendosja e një mjeti lidhës midis dyshemesë dhe PVC-së dhe shtresës ekzistuese të dyshemesë (kjo zakonisht ndodh në pjesët lidhëse dhe në pjesët lidhëse me instalimet e kompjuterëve).	X Pastruese për mur; X Rulë.
Sipërfaqe të dëmtuara si rezultat i ndërrimit jo të rregullt të shtresave të mobilieve (banka dhe karrige).	X Vendoset mjet lidhës midis dyshemesë prej PVC-së dhe shtresës ekzistuese të dyshemesë; X Aplikohet me rulë që të mënjanohet teprica e materialit, si dhe të bëhet shtypje që më mirë të aplikohet mjeti lidhës; X Vendoset gjësend i rëndë, i cili duhet të qëndrojë 12 orë, që të mundësohet bashkim më i mirë; X Aplikohet lyerja finale që të bashkohen skajet e dy pjesëve përtë mos u shkëputur pjesa e dëmtuar.	X Pastrues X Rulë; X Trapanë

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

2.1. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: PJESA NDERTIMORE

2.1.5.2. MIRËMBAJTJA E NYJAVE SANITARE

ZGJIDHJA E PROBLEMEVE GJATË MIRËMBAJTJES SË NYJAVE SANITARE		
PROBLEME	MASA	VEGLA TË NEVOJSHME
Riparimi i kasetës së tualetit ku vazhdimisht rrjedh nga pak ujë në guackë.	Ekzistojnë dy mënyra të riparimit të kazanit: X Hiqeni kapakun e kazanit, nëse uji derdhet jashtë gypit për rrjedhje, kjo do të thotë se defekti qëndron te mbushësi. Tërhiqeni galixhantin lartë dhe nëse uji ndalon së rrjedhuri, nevojitet vetëm rregullimi i nivelit të ujit, pa ndërruar asgjë; X Në rast se rrjedh uji, pasi të tërhiqet galixhanti me dorë, duhet të riparohet ose të ndërrohet ventili. Fillimisht duhet të shkyçet përçimi i ujit në kasetë (mbyllet ventili para zorrës fleksibile) dhe demontohet pjesa e ventilit ku bën pjesë galixhanti, ndërsa më pas ndërrohet me një të ri.	X Dara; X Kaçavidhë; X Burgi.
Riparimi i përçuesit të ujit.	Për të liruar përçuesin e ujit në lavaman ekzistojnë tri mënyra: X Mjeti për lirim – nuk duhet të përdoret në rast se gypat janë zënë në tërësi. Gjithmonë duhet të ndiqet udhëzuesi i prodhuesit; X Përdorimi i gomës nën vakum – kur përdoret goma, në lavaman duhet pasur ujë. Vendosni gomën mbi përçuesin e lavamanit dhe lëvizeni dorezën lartë-poshtë. Goma gjatë tërë kohës duhet të jetë në mes të përçuesit që të jetë statik; X Pastrimi i sifonit – Fillimisht lirojeni sifonin me çelës përkatës dhe hiqeni. Më pas merrni një enë për mbledhjen e ujit i cili do të derdhet, ndërsa më pas vendoseni sifonin e ri. Kur ta ndërroni sifonin, kontrolloni nëse gomat janë të shtrënguara dhe të forta, pasi që nëse janë të çliruara dhe të buta nuk do të qëndrojnë dhe sifoni do të rrjedh.	X Dara; X Kaçavidhë; X Gomë nën vakum; X Burgi.
Riparimi i çezmave, rubinetave dhe ventileve.	X Ndërrimi i gomave; X Ndërrimi i ventilit; X Ndërrimi i çezmave.	X Dara; X Kaçavidhë; X Burgi.

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

2.1. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: PJESA NDERTIMORE

ZGJIDHJA E PROBLEMEVE GJATË MIRËMBAJTJES SË OBORREVE SHKOLLORE		
PROBLEME	MASA	VEGLA TË NEVOJSHME
Mirëmbajtjae drunjve, shkurrevedhe gardhit.	X Mënjanini i rregullt i degëve të vjetra të vdekura; X Krasitja e rregullt e gardhit dhe formësimi i tij; X Shkurtimi i rregullt i drunjve.	X Makinë elektrike për formësimin e gardhit; X Gërshër për gardh dhe krasitje; X Lopatë; X Krehër kopshti; X Dorezë.
Mirëmbajtjae rrethojës së shkollës.	X Lyerja e rrethojës bëhet në interval kohor prej 3 deri në 5 vjet; X Lyerja e rregullt e shulave të dyerve, bravavenë dyert hyrëse.	X Furçë; X Doreza.

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIRËMBAJTJES

2.1. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: PJESA NDERTIMORE

2.1.6.2. MIRËMBAJTJA E SHTIGJEVE SHKOLLORE

Mirëmbajtja e shtigjeve shkollore para së gjithash varet nga materiali i përdorur, kështu që dallojmë:

- Shtigje shkollore me sipërfaqe betoni – gjatë mirëmbajtjes, fillimisht duhet kontrolluar sipërfaqet prej betoni, të bëhet përcaktimi i sipërfaqeve të dëmtuara, gjegjësisht ku paraqiten vrima dhe gropa. Këto dëmtime fillimisht duhet të lyhen me aditiv për ngjitje, ndërsa më pas vendoset armaturë rrjetore (që të mos thërrmohen sipërfaqet prej betoni) dhe në fund të betonohen.
- Shtigje shkollore me elemente prej bekatoni – fillimisht duhet kontrolluar shtigjet shkollore, gjegjësisht duhet kontrolluar të gjitha elementet prej bekatoni, si dhe pragjet e trotuareve që e formojnë shtegun shkollor. Pasi të përcaktohen pjesët e dëmtuara, duhet bërë sanimi i tyre, gjegjësisht zëvendësimi i elementeve prej bekatoni me të reja. Procedura për ndërrimin e tyre është e thjeshtë, hiqen elementet e dëmtuara dhe vendosen të rejat, ndërsa më pa
mbi to që të lidhen midis tyre.

ZGJIDHJA E PROBLEMEVE GJATË MIRËMBAJTJES SË SHTIGJEVE SHKOLLORE DHE TERRENEVE SPORTIVE		
PROBLEME	MASA	**VEGLA TË NEVOJSHME**
Shtigje të dëmtuara.	X Kontrolli i sipërfaqeve prej bekatoni; X Përcaktimi i sipërfaqeve të dëmtuara, vrimavedhe gropave; X Betonimi. X Riparim I siperfaqeve me goine / tartan / bar artificial etj	**X Furçë; X Doreza; X Lopatë.**
Terrene sportive – ripërtëritja e pjesëve të dëmtuara	**X Pastrimi i tërë sipërfaqes;** **sportive me lyerjeme bojë;** **X Lyerja e pajisjeve të fushave sportive (kosha, gole etj.) me bojë.**	**X Furçë; X Doreza; X**

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

2.1. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: PJESA NDERTIMORE

2.1.6.2. MIRËMBAJTJA E SHTIGJEVE SHKOLLORE

Mirëmbajtja e shtigjeve shkollore para së gjithash varet nga materiali i përdorur, kështu që dallojmë:

- Shtigje shkollore me sipërfaqe betoni – gjatë mirëmbajtjes, fillimisht duhet kontrolluar sipërfaqet prej betoni, të bëhet përcaktimi i sipërfaqeve të dëmtuara, gjegjësisht ku paraqiten vrima dhe gropa. Këto dëmtime fillimisht duhet të lyhen me aditiv për ngjitje, ndërsa më pas vendoset armaturë rrjetore (që të mos thërrmohen sipërfaqet prej betoni) dhe në fund të betonohen.
- Shtigje shkollore me elemente prej bekatoni – fillimisht duhet kontrolluar shtigjet shkollore, gjegjësisht duhet kontrolluar të gjitha elementet prej bekatoni, si dhe pragjet e trotuareve që e formojnë shtegun shkollor. Pasi të përcaktohen pjesët e dëmtuara, duhet bërë sanimi i tyre, gjegjësisht zëvendësimi i elementeve prej bekatoni me të reja. Procedura për ndërrimin e tyre është e thjeshtë, hiqen elementet e dëmtuara dhe vendosen të rejat, ndërsa më pas mbi to që të lidhen midis tyre.

2. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: SISTEMI PËR NGROHJE DHE KALDAJA



ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIRËMBAJTJES

2. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: SISTEMI PËR NGROHJE DHE KALDAJA

2.2.1. PROCEDURA PËR MIRËMBAJTJE PARANDALUESE DHE PËRDORIMI

Hapi më i rëndësishëm gjatë mirëmbajtjes parandaluese të sistemeve për ngrohje është përpunimi i dokumenteve për eksploatimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin (EMP) e vetë sistemeve. Hapi tjetër është trajnimi i personelit teknik për ndjekjen e procedurave për EMP.
Zakonisht në shkolla, caktohet vetëm një person, anëtar i personelit teknik, i cili kujdeset për punën dhe mirëmbajtjen e sistemit për ngrohje (Kritere për përcaktimin e numrit të nevojshëm të punëtorëve në veprimtarinë e arsimit fillor, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 2003). Gjithashtu, zakonisht sistemi për ngrohje menaxhohet nga personeli teknik në përvojës së fituar gjatë punës gjatë viteve të kaluara. Tek sistemet më të mëdha pë qendrore, kur operatori mungon në punë, ekziston rreziku që sistemi për ngrohje të pun vështirësi ose të mos funksionojë fare, pasi që nuk ka personel tjetër të trajnuar për këtë qëllim. Për operimin me kaldajat për ngrohje qendrore me fuqi instaluese deri në 200 kW, rregullorja nuk parasheh dhënien e provimit për aftësim profesional, ndërsa për impiantet me fuqi instaluese prej 200 kW dhe më shumë, shtypje prej 0,5 bar, temperaturë prej 110 °C të ujit dalës, duhet që operatori ta ketë dhënë provimin për aftësim profesional, në pajtim me Rregulloren.

Zgjidhja ideale është të ketë minimum dy të punësuar të personelit teknik të cilët do të obligohen për mirëmbajtjen dhe punën e sistemeve për ngrohje.

Në pajtim me rregullativën teknike të kësaj fushe, në çdo kaldajë duhet pasur në mënyrë të patjetërsueshme udhëzim detajues për funksionimin e të gjithë instalimit për ngrohje, bashkë me listën e inventarit të të gjithë pajisjes, si dhe projekti i zbatimit të instalimit të përgjithshëm për ngrohje. Përveç udhëzuesit të detajuar për punë, duhet bërë udhëzim i shkurtër për punë, i cili do t'i përmbajë funksionet kryesore dhe të vendoset në një vend të dukshëm të kaldajës.

2. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: SISTEMI PËR NGROHJE DHE KALDAJA

2.2.1. PROCEDURA PËR MIRËMBAJTJE PARANDALUESE DHE PËRDORIMI

X Siguri dhe mbrojtje gjatë punës;

X Intervenim të shpejtë në rast të parregullsisë dhe avarisë së pajisjeve;

X Mundësi për menaxhim me pajisjet e personave të tjerë në mungesë të personit të personelit teknik i cili është caktuar për sistemin për ngrohje;

X Njohjen e llojit dhe karakteristikave të pajisjeve, me çka do të bëhet ndërrimi i drejtë dhe në kohë i pajisve të prishura;

X Ndjekje planore e procedurave për mirëmajtjen parandaluese të pajisjeve;

X Prezentim i saktë për të gjitha pjesët nëntokësore dhe të fshehat të instalimit.

Dokumentet duhet të përmbajnë instruksione të përpunuara në një formë të caktuar dhe me ra e të caktuar. Instruksionet duhet t'i përmbajnë kërkesat e projektuara për eksploatimin dhe mirëmbajtjen e sistemit. Këto instruksionet mund të jepen si pjesë e instruksioneve për tërë objektin.

X Dokumentet për EMK duhet të përmbajnë instruksione për pajisjet dhe komponentët e prodhuesve. Nëse projektuesi i sistemit përdor disa komponenta të cilat nuk janë specifikuar në instruksionet e prodhuesve, atëherë kjo duhet sqaruar dhe theksuar në dokument;

X Dokumentet duhet të jenë të qarta dhe të përpunuara në formë të pandryshueshme. Duhet të jenë të shtypura në material i cili nuk fshihet, përkatës për përdorim të përditshëm;

X Formati, stili dhe numri i kopjeve të dokumenteve për EMK duhet të jetë në pajtim me marrëveshjen midis pronarit dhe projektuesit të sistemeve. Duhet të ekzistojë listë në cilat vende duhet dërguar dokumenti;

X Një kopje e dokumentit për EMK duhet të përgatitet për përdorim nga ana e personave të vendosur për eksploatimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e sistemeve;

2. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: SISTEMI PËR NGROHJE DHE KALDAJA

2.2.1. PROCEDURA PËR MIRËMBAJTJE PARANDALUESE DHE PËRDORIMI

2.2.2. PLAN VJETOR I AKTIVITETEVE PËR MIRËMBAJTJEN E SISTEMEVE PËR NGROHJE

Çdo pjesë e sistemit duhet të testohet sipas një Plani të aktiviteteve i përgatitur paraprakisht. Periudha jashtë sezonit për ngrohje është më e përshtatshme për zbatimin e mirëmbajtjes parandaluese të sistemeve për ngrohje. Në këtë periudhë duhet të bëhen kontrollet vjetore dhe testimet e pajisjeve dhe sipas nevojës të bëhen riparime.

Për çdo kaldajë duhet të përpunohet plan i aktiviteteve të cilat duhet të zbatohen para fillimit të sezonit për ngrohje. Plani i aktiviteteve do të pjesë përbërëse e udhëzuesit për punë dhe paraqet dokument i cili do të mundësojë kontrolle sistematike në mbarë sistemin.

Pajisja e makinave duhet të kontrollohet dhe servisohet në pajtim me udhëzuesit e prodhuesit të pajisjeve. Të gjitha servisimet dhe konfigurimet e pajisjeve do të bëhen gjatë kont nevojitet ndërrimi i ndonjë pajisje të caktuar, personi i cili e kryen mirëmbajtjen ı obligohet në kohë të bëjë porositjen e pajisjes përkatëse dhe punëve të tjera të nev funksionimin e sërishëm të sistemit.

2.2.3. PLAN I AKTIVITETEVE PËR EKSPLOATIM DHE MIRËMBAJTJE

Me përgatitje të mirë dhe mirëmbajtje të rregullt parandaluese, aktivitetet në sezonin për ngrohje do të reduktojnë punën e sistemit për ngrohje, ndjekjen e punës së tij, op- timizmin e punës dhe riparimet e përkohshme. Në tabelat: Plani i aktiviteteve për ek- sploatimin dhe mirëmbajtjen e kaldajave për ngrohje dhe Planin mujor të aktiviteteve për eksploatimin dhe mirëmbajtjen e sistemit për ngrohje (shiko Aneksin 4 dhe 5) janë dhënë aktivitetet për përdorimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi tipik për ngrohje qen- drore pa menaxhim automatik. Aktivitetet janë ndarë në:

ANEKSI NR. 4- MANUALI I MIREMBAJTJES

2. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: SISTEMI PËR NGROHJE DHE KALDAJA

2.2.1. PROCEDURA PËR MIRËMBAJTJE PARANDALUESE DHE PËRDORIMI

X Rutina ditore të cilat fillojnë me: startimin e sistemit, ndjekjen dhe kontrollet ditore dhe përfundojnë me shkyçjen e sistemit;

X Kontrolle të domosdoshme javore;

X Kontrolle të domosdoshme mujore.

2.2.3.1. LËSHIMI NË PËRDORIM

Matja e temperaturës së jashtme dhe të brendshme. Te sistemet e drejtuara në mënyrë automatike ky operacion i leximit të temperaturës zhvillohet në vazhdimësi dhe në mënyrë automatike. Por, pasi që shumica e sistemeve nuk drejtohen në mënyrë au- tomatike, personi teknik i obliguar për menaxhimin e sistemit duhet në mënyrë man- uale ta lexojë temperaturën.

Kontrolli i sasisë ditore dhe furnizimi me karburant. Çdo mëngjes operatori duhet të kontrollojë dhe të sigurohet se ka sasi të mjaftueshme të lëndës djegëse për punën e papenguar të sistemit për një ditë. Nëse bëhet fjalë për lëndë djegëse të ngurta, duhet të sillen në sallën e kaldajave në lokacionin e dedikuar për sistemimin e lëndëve djegëse të ngurta.

Nëse lënda djegëse është e lëngshme, atëherë preferohet në kaldaja apo në afërsi të saj të ketë rezervoar ditor për karburant, i cili ka indikator apo matës të sasisë së karburantit. Nëse nuk ka karburant të mjaftueshëm, atëherë duhet të bëhet pompimi i lëndës djegëse të lëngshme nga rezervuari sezonal. Aktivizohet pompa për karburant, e cila fillon ta mbush rezervoarin ditor. Gjatë tërë operacionit prania e operatorit është e domosdoshme që të mos vijë deri te stërmbushja dhe rrjedhja e rezervuarit
ditor.
Kontrolli i shtypjes në instalim. Para se të lëshohet në përdorim duhet të kontrollohet shtypja e instalimeve, e cila te ngrohja zakonisht është konfiguruar në
2 bar. Shtypja e punës lexohet nga manometri, i cili mund të instalohet në gyp apo në kazan. Nëse vjen deri te rënia e shtypjes nën 1,5 bar, kjo do të thotë se diku në sistem ka rrjedhje. Atëherë duhet të zbulohet problemi dhe
të sanohet.

2. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: SISTEMI PËR NGROHJE DHE KALDAJA

2.2.1. PROCEDURA PËR MIRËMBAJTJE PARANDALUESE DHE PËRDORIMI

Kaldajat mund të përdorin:

X Lëndë djegëse të ngurta:

X Drunj;

X Qymyr (guri, linjit, antracit, koks....);

X Briketa;

X Peleta.

XX Lëndë djegëse të lëngshme:

X Vajra minerale – naftë apo mazut.

XX Lëndë djegëse të gazta:

X Gaz natyral (metan);

X Gaz nafte i lëngshëm (GNL – propan butan).

Kaldajat për karburante të ngurta ndezen me dorë. Pas ndezjes dhe startimit, ndizet zjarri dhe i shtohet lëndë djegëse derisa kaldaja nuk e arrin temperaturën e punës. Rregullimi i temperaturës bëhet me dorë dhe bëhet me shtimin e lëndëve djegëse në zjarr apo rregullimin e shkujës e cila ndodhet në çdo kaldajë të tillë. Temperatura optimale me të cilat duhet të punojnë këto kaldaja është në interval 70–900C.

2. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: SISTEMI PËR NGROHJE DHE KALDAJA

2.2.1. PROCEDURA PËR MIRËMBAJTJE PARANDALUESE DHE PËRDORIMI

Kaldajat me ujë të nxehtë dhe lëndë djegëse të lëngshme dhe të gaztë janë pajisur me aparat djegës të cilat e djegin lëndën djegëse dhe lirojnë nxehtësi e cilan e nxen kaldajën. Puna e aparateve për djegie mund të jetë automatike, por zakonisht është gjysmëautomatike, me kusht kaldaja ta ketë automatikën e saj. Lëshimi në përdorim bëhet në mënyrë manuale, gjegjësisht startimin e aparatit djegës e aktivizon operatori. Operatori e konfiguron temperaturën e dëshiruar të ujit që duhet ta arrijë kaldaja përmes termostatit me automatikë. Aparati për djegie do të punojë derisa të arrihet temperatura e dëshiruar.

Kaldajat me ujë të nxehtë konfigurohen që të punojnë në temperatura të arta se 700C me ç'rast arrihet efikasitet i madh në punë. Nëse temperatura punu ë 700C, efikasiteti i tij bie dukshëm.

Kur ta arrijë temperaturën e punës, aparati për djegie në mënyrë automatike shuhet dhe pushon derisa temperatura e ujit në kaldajë fillon të bie në kufirin e poshtëm 55 – 600C. Nëse menaxhimi bëhet në mënyrë automatike, aparati për djegie do të aktivizohet vetë, ndërsa nëse është në mënyrë manuale, nevojitet prania e operatorit për kyçje dhe shkyçje.

Kontrolli i trupave për ngrohje. Bëhet kontrolli i radiatorëve. Nëse ndonjëri prej radiatorëve nuk ngroh mjaftueshëm ose ngroh me temperaturë më të vogël në komparim me të tjerat, atëherë bëhet fjalë për ajër të robëruar. Ajri i robëruar nga radiatori lëshohet përmes ventilit termorregulla- tor, i cili duhet të jetë në zonën e sipërme të çdo radiatori. Nëse nuk ka ventile termorregulluese në radiatorë, atëherë duhet pasur në pjesën e lartme të rrjetit me gypa. Ekzistojnë ventile të ndryshme termorrgulluese dhe të gjitha janë të thjeshta për përdorim. Ventili duhet të qëndrojë i hapur deri sa nuk del ajri në tërësi dhe derisa nuk fillon të rrjedh ujë. Në këtë mome

2. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: SISTEMI PËR NGROHJE DHE KALDAJA

2.2.1. PROCEDURA PËR MIRËMBAJTJE PARANDALUESE DHE PËRDORIMI

REGJIMI I PUNËS SË KALDAJAVE:

Në periudha kur temperaturat e jashtme janë mbi 0°C, salla e kaldajave ndoshta nuk duhet të punojë me kapacitet të plotë. Nëse ekziston vetë një kaldajë, atëherë temperatura në kaldajë duhet të lëvizë në kufijtë e poshtëm apo rreth 70°C.

Atje ku sistemet kanë dy ose më shumë kaldaja, nevojitet sasi më e vogël e nxehtësisë në sistem, atëherë më efikase është të punojë një kaldajë me mbingarkesë maksimale se da kaldaja në 50% të kapacitetit.

Nëse janë një apo më shuma kaldaja, atëherë fillon me punë vetëm një kaldajë. Nëse njëra prej kaldajave nuk mund t'i kënaq nevojat gjatë kapacitetit maksimal, atëherë kyçet edhe kaldaja tjetër. Ditën e ardhshme duhet të punojë kaldaja tjetër, ditën e tretë përsëri kaldaja e parë etj. Qëllimi i rotacionit të funksionimit të pajisjeve është për eksploatim të balancuar dhe rritjen e jetëgjatësisë.

Përfitime: Optimizimi i sistemit përmes punës së kaldajave në pikën e efikasite
rritjes së jetëgjatësisë së pajisjeve përmes mbingarkesës së barabartë dhe përdo
elementeve të sistemit.



FOTOGRAFIA 18: Procedura për shuarjen e sistemit për ngrohje

2. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: SISTEMI PËR NGROHJE DHE KALDAJA

2.2.1. PROCEDURA PËR MIRËMBAJTJE PARANDALUESE DHE PËRDORIMI

REGJIMI I PUNËS SË KALDAJAVE:

2.2.4. PUNA E SISTEMEVE NË KUSHTE PARREGULLSIE APO AVARIE DHE ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

Në përbërje të dokumentacionit për EMK, duhet pasur instruksione për menaxhimin me sistemin në kushte të parregullsisë apo avarisë së pajisjeve dhe për zgjidhjen e problemeve. Në këtë pjesë të dokumentacionit duhet të përshkruhen të gjithë skenarët e mundshëm të parregullsisë së pajisjeve dhe procedurave për ndërrim në rast avarie.

2. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: SISTEMI PËR NGROHJE DHE KALDAJA

ZGJIDHJA E PROBLEMEVE TE SISTEMET PËR NGROHJE ME LËNDË DJEGËSE TË NGURTA		
SIMPTOMA	SHKAKU	MASA
Nxehtësi e pamjaftueshme.	X Furnizimi i pamjaftueshëm i lëndëve djegësetë ngurta; X Sasi e madhe e lëndëve djegësetë ngurta; X Shkujë e pamjaftueshme në vatër.	X Rriteni furnizimin e lëndëve djegësetë ngurta dhe rregulloni furnizimin me ajër; X Rriteni furnizimin me ajër dhe zvogëlojeni furnizimin me lëndë djegësetë ngurtë; X Kontrolloni punën e oxhakut.
Nxehtësi e madhe.	X Sasi e madhe e lëndëve djegësetë ngurta; X Sasi e madhe e shkujës.	X Zvogëloni furnizimin me lëndë djegësetë ngurtë dhe rregulloni furnizimin me ajër; X Rregulloni furnizimin me ajër.
Kthimi i tymit nga oxhaku.	X Sasi e pamjaftueshme e ajrit për djegie; X Vatër e pamjaftueshme.	X Rriteni furnizimin me ajër. Kontrolloni sistemin për furnizim me ajër dhe oxhakun. Pastroni, nëse është e nevojshme; X Konsultohuni me prodhuesin.
Rritja e nxehtësisë në kaldajë dhe rritja e shtypjes në instalim.	X Ndërprerja e punës së pompës qarkulluese për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike apo për ndonjë arsye tjetër.	X Ndaloni furnizimin me lëndë dj dhe ajër; X Kyçeni pompën qarkulluese të gjeneratorit; X Uleni shtypjen me dorë; X Rregullisht bëni kalibrimin dhe servisimin e ventilëve të sigurisë; X Gjatë projektimit të sistemit duhet instaluar rezevuari i cili do ta amortizojë nxehtësinë e tepërt.

2. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: SISTEMI PËR NGROHJE DHE KALDAJA

ZGJIDHJA E PROBLEMEVE TE SISTEMET PËR NGROHJE ME LËNDË DJEGËSE TË LËNGSHME		
SIMPTOMA	SHKAKU	MASA
Kushte të ndryshueshme të punës në vatër gjatë startit, ndalimit dhe gjatë punës së vazhdueshme të aparatit djegës.	X Puna jo e rregullt e grykës; X Shkujë e pamjaftueshme.	X Rregullimi dhe ndërrimi i grykës; X Rregullimi i shkujës dhe kontrolli i oxhakut.
Paraqitja e zhurmës gjatë punës së pompës.	X Ajër i ngujuar në gyp; X Paraqitje e mundshme e rrjedhjes në gypërçues; X Zënia e filtrit (papastërti).	X Lirimi i ajrit në gypërçues; X Kontrolli i rrjedhjeve dhe sanimeve të defekteve; X Pastrimi i filtrit.

2. MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SHKOLLORE: SISTEMI PËR NGROHJE DHE KALDAJA

2.2.5. RRITJA E EFIKASITETIT DHE REKOMANDIMEVE PËR OPTIMIZMIN E SISTEMEVE

